



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
**Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragas/ Dragas Municipality**

**- Kuvendi Komunal**

**01 Nr.06-380/2**

**Dt.26.03.2013**

**D r a g a s h**

Kuvendi Komunal i Dragashit, në bazë të nenit 40 e 68 pët Vetëqeverisje Lokale, neneve 13,14 e 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash, konform Ligjit nr.2003/14 të Planifikimit Hapësinor i ndryshuar me Ligjin 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, Ligjin nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, si dhe nenit 13 të Planit Zhvillimor Komunal, në seancën e dt.26.03.2013, pasi se preparakisht delegatët kishin marr si material draftin e hartuar nga UNDP-ja për Planin Zhvillimor Komunal & Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Komunës së Dragashit , për vitin 2012-2022 , miraton këtë:

## V E N D I M

- I. **JEPET PËLQIMI** për shpalljen dhe zbatimin e Diskutimit Publik lidhur me këto dokumente zhvillimore-strategjike për komunën e Dragashit.
- II. Dokumentet në fjalë (verzioni elektronik) do të jenë të publikuara në web-faqen e Komunës Dragash ku gjendet edhe një formular për shprehjen e komenteve. Materiali-kopja fizike mund të merret në njërin nga zyrat e Shtëpisë së Kulturës-Dragash, ku do të jetë prezent edhe një zyrtar Drejtoratit të Urbanizmit të Komunës-Dragash, për të dhënë sqarime dhe pranuar komente- plotësime eventuale dhe për t'u nënshkruar në fletoren zyrtare të komenteve.
- III. Periudha konsultative e diskutimit publik fillon më 04.04.2013 dhe vazhdon deri më 04.06.2013, gjithësejt 60 ditë.
- IV. Në ndërkohë, përkatësisht më 08 maj-2013 në ora 10,00, në sallën e Kuvendit Komunal të Dragashit, do të mbahte edhe një Diskutim Publik lidhur me këto dokumente. Njoftimi i qytetarëve për Diskutimin - Debatin Publik bëhet, të paktën 15 ditë, para mabjtjes së Diskutimit Publik. Njoftimi do të bëhet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës", web-faqen zyrtare-Komunale dhe në radiot lokale.
- V. Pas kësaj periudhe konsultative, Plani Zhvillimor së bashku me një Raport të komenteve dhe sugjerimeve nga Diskutimi Publik, i përmbledhur nga UNDP-ja do t'i dërgohen Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- VI. Pas aprovimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Kuvendi Komunal, në një seancë, do të miraton zyrtarisht këto dokumente të Komunës-Dragash.



**KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH**

**Kryesuesi**

*Shaban Shabani*